

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI : “Rikonstruksion çatie për repartin e praktikës (stallë) për shkollën profesionale “Irakli Terova”

-PRISHJE ÇATIE

Prishja komplet e të gjithë sipërfaqes së çatisë deri në daljen e kapriatave metalike egzistuese, duke përfshirë skelat e shërbimit ose skelerinë , spostimin e materialit që rezulton brenda ambientit të objektit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund heqjes së çatisë.

-PRISHJE E TAVANIT ME KOCE

Prishja komplet e të gjithë sipërfaqes së tavanit deri në daljen e kapriatave metalike egzistuese, duke përfshirë skelat e shërbimit ose skelerinë , spostimin e materialit që rezulton brenda ambientit të objektit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund heqjes së tavanit me koce.

-PRISHJE E SUVATIMIT

Prishja komplet e të gjithë sipërfaqes së suvatuar deri në daljen e muraturës, larje e sipërfaqeve të prishura me ujë me presion, duke përfshirë skelat e shërbimit ose skelerinë , spostimin e materialit që rezulton brenda ambientit të objektit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund heqjes së suvase.

-PRISHJE E SHITRESE BETONI

Prishja komplet e të gjithë sipërfaqes së shtresës të betonit të dëmtuar, spostimin e materialit që rezulton brenda ambientit të objektit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund heqjes së shtresës të betonit.

-GERMIM DHEU SHKARKIM NE MJET

Në këtë çmim parashikohet tërësia e shpenzimeve që nevojiten për realizimin e 1 m³ gërmim dheu rreth objektit, pavarësisht nga kategoria e tokës me mjete të mekanizuar. Gërmimi të bëhet duke patur parasysh detajet teknike dhe përmasat sipas profilave gjatësor dhe tërthor.

-GERMIM DHEU ME KRAH E TRANSPORT ME KAROCE DORE

Në këtë çmim parashikohet tërësia e shpenzimeve që nevojiten për realizimin e 1 m³ gërmim dheu themel me krah , pavarësisht nga kategoria e tokës . Gërmimi të bëhet duke patur parasysh përmasat sipas profilit dhe kushtet teknike dhe transportin me karrocë dore deri në 10 m.

-TRANSPORTET MATERJALE MDERTIMI ME AUTO

Ngarkim dhe transport me shkarkim, me çfarëdo mjeti, të materialit që rezulton nga gërmimet, prishjet etj... të çfarëdo natyre dhe lloji, edhe nëqoftëse është i lagur, për largimin e tyre nga kantieri në çfarëdo distance dhe niveli, duke përfshirë shkarkimin dhe rrafshimin nëse është i nevojshëm.

-PUNIME MURATURE TULLE

Në këtë çmim parashikohet tërësia e shpenzimeve që nevojiten për realizimin e 1 m³ mur tulle të lehtësuar Ilaç i perzier M=25 për ndërtimin e mureve sipas detajit teknik me gjerësi dhe lartësi sipas projektit . Në çmim futet tërësia e shpenzimeve për blerjen e materialeve rërë guri, çimento,tullat, transportin. Ilaçi të prodhohet me betoniere në objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rërë guri, të realizohet marka e kërkuar e Ilaçit.

-F.V. Konstrksion metalik I gatshem

Në këtë çmim parashikohet tërësia e shpenzimeve që nevojiten për realizimin e 1 kg konstruksioni metalik për detajet përkatëse në kapriatat egzistuese për montimin e risteleve të çatisë dhe tavanit. Ne çmim futet tërësia e shpenzimeve për blerjen e materialeve si dhe montimi në kapriaten përkatëse sipas kushteve teknike.

-MBULIM ÇATIE ME TJEGULLA BETONI

Do të realizohet me ristela druri 5x5 cm të cilat do të mbështeten mbi kapriatat egzistuese të çatisë. Lënda e drurit do të jetë e stazhjonuar në mënyrë natyrale ose artificiale prej pishe. Ristelat e çatise do të jenë 5x5 në çdo 33 cm.

Tjegullat do të jenë prej betoni importi cilësi e parë, të gozhduara ose të lidhura duke përfshirë lidhjen e ullqeve horizontale të çatisë dhe kulmeve duke përdorur Ilaç bastard M-25 tel xingato, skelari ose çdo ndryshim tjetër të nevojshem për ta përfunduar punën.

-ULLUKE VERTIKALE

Ulluket vertikale për shkarkimin e ujrave të çatisë të jenë PVC me diametër 12 cm. Në çdo ulluk duhet të mblidhen ujrat e një sipërfaqe çatie jo më të madhe se 60 m². Ulluket duhet të vendosen në pjesën e jashtme të ndërtesës me anë të qaforeve përkatëse prej çeliku të xinguara , të fiksuar çdo 1.5 m. Pjesa fundore e ullqeve të jetë mbërthyer fort me ganxha hekuri si dhe poshtë duhet të kthehen 90 gradë.

-ULLUKE HORIZONTALE

Realizohen me pjerrësi prej 1% për largimin e ujrave. Kurse ulluket horizontale prej xingato kanë diametër 12 cm. Në çdo ulluk duhet të mblidhen ujrat e një sipërfaqe çatie jo më të madhe se 60 m². Ulluqet horizontale me llamarinë xingato me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5cm , të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj, me bord të jashtëm 2cm më të ulët se bordi i brendshëm të kompletuara me pjesë speciale në grykën e hyrjes . Ulluku horizontal i modeluar sipas udhëzimeve në projekt, duhet të jetë i lidhur me tel xingato me hallka të forta të vëna maksimumi në 70 cm.

-SUVATIMI I BRENDESHEM

Suvatimi i brendshëm do të realizohet mbasi të jenë bërë të gjith instalimet elektrike.Përpara se të suvatohet do të bëhet sprucimi i mureve dhe taveve .Para sprucimit sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë.Sprucimi i mureve dhe i taveve do të behet me Ilaç çimento të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rificimin e sipërfaqes së muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin. Suvatimi me drejtues i realizuar me një shtresë me trashësi 2cm Ilaç bastard M-25 me përmbajtje rëre e larë 0.005 m³ , Ilaç gelqere M-1 :2 ,0.003 m³, çimento 400, 6.6 kg e uje i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure e lëmuar me mistri e

bërdaf ,duke përfshire skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

-SUVATIM I JASHEM

Sprucimi i mureve me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshire skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund sprucimit. Suvatimi i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard M_25 dozim për m² rërë e larë m³ 0.005 m³, llaç bastard m³ 0.03 , çimento 400 7.7kg , ujë e aplikuar në bazë të udhëzimeve të përgatitura në mure dhe e lëmuar me mistri e bërdaf, duke përfshire skelat e shërbimit dhe çdo shërbim tjetër . Për ti dhënë plotësisht fund sprucimit.

-TAVAN RRJETE TELI+SUVA

Suvatimi i tavanit do të realizohet mbasi të jenë bërë të gjithë instalimet elektrike . Perpara se të suvatohet do të vendoset rrjete teli dopjo të mbërthyera me ristela pishe pastaj do të bëhet suvatimi i taveve . Sprucimi i taveve do të bëhet me llaç çimento të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë duke përfshire skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Suvatimi me drejtus i realizuar me një shtresë me trashësi 2cm llaç bastard M-25 me përmbajtje rërë e larë 0.005 m³ , llaç gëlqere M- :2 ,0.003 m³, çimento 400, 6.6 kg e ujë i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure e lëmuar me mistri e bërdaf ,duke përfshire skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

-PUNIME BOJATISJE

Në zërin e lyerjes është parashikuar lyerje me bojë vaji në sipërfaqe metalike. Lyerja do të jetë e një cilësie të lartë duke parashikuar të gjitha kushtet teknike, para lyerjes me bojë vaji të lyhet me antiruxhio, si dhe materialet e nevojshme sipas normativave në fuqi.

-SUVATIM I XOKOLI ME GRANIL E CIMENTO TE ZAKONSHME

Sprucimi i xoklatures me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës. Suvatimi i realizuar nga një shtresë me trashësi 2cm llaçi çimento me granil.

-DRITARE DURALUMINI PLASTIK

Furnizimi dhe vendosja e dritareve siç parashikohet në specifikimet teknike me dimensione të dhëna nga kontraktori përbëhet nga material duralumini plastik me dopio xham profilet e të cilave janë sipas standarteve europiane EN 573-3 dhe janë profile të lyera përpara se të vendosen në objekt .Ngjyra e dritareve do të jetë në ngjyrën e drurit dhe forma e saj siç parashikohet në projekt .

Korniza fikse e dritares do të jetë me dimensione 61_90 mm. Ato jenë të siguruar me elemente që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit, si dhe në pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të dritares .Forma e skeletit është tubolare që të mbledhë të gjithë aksesorët e saj .Profili i kanatës së dritares do të jetë me dimensione të tilla 25 mm që të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur .

Para vendosjes së dritareve do të vendosen divenciale mermeri me t=30 mm . Në dritaret nga ana e jashme mermeri duhet të dalë nga muri 5 cm.

-SHTRESE ME PLLAKA VETESHTRËNGUESE $t = 6 \text{ cm}$

Në këtë çmim parashikohet tërësia e shpenzimeve që nevojiten për realizimin e 1 m^2 shtresë pllake vetështrënguese pas bërjes së shtresës rërës duke patur parasysh kuotat e shtresës. Në çmim futet tërësia e shpenzimeve për blerjen e pllakave parafabrikat betoni $t=6\text{cm}$, transportin shpërndarjen e tyre si dhe vendosja e tyre mbushjen e fugave me rërë. Fiksimi i pllakave do të bëhet në beton M-200. Pllakat duhet të jenë të shoqëruar me çertifikatën e cilësisë. Për llojin e pllakave të merret miratimi nga Investitori. Pllakat duhet të jenë të shoqëruar me çertifikatën e cilësisë.

-STRUKTURE MONOLITE BETON C – 20/25

Në këtë çmim parashikohet tërësia e shpenzimeve që nevojiten për realizimin e 1 m^3 beton C–20/25 për ndërtimin e kanaleve sipas detajit teknik me gjerësi dhe lartësi sipas faktit, duke rrespektuar kuotat .Në çmim futet tërësia e shpenzimeve për prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , çimento, transportin, dhe hedhjen në vepër . Ne çmim futet dhe testet e bëra për markën e betonit. Betoni të merret i gatshëm nga një nyje e mekanizuar ose të prodhohet me betoniere në objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rërë guri + çakëll, të realizohet marka e kërkuar e betonit. Në çmim futet dhe testet e bëra për markën e betonit. Të përdoret rërë guri.

-SPECIFIKIME ELEKTRIKE TE PERGJITHSHME

Aksesorët e instalimeve elektrike do të specifikohen në mënyrë të detajuar në pikat e mëposhtme të këtij seksioni.

Të gjithë materialet duhet ti plotësojnë kërkesat e përgjithshme të kushteve teknike të zbatimit që duhet të plotësojnë këta aksesorë dhe në përgjithësi instalimet elektrike . Instalimi elektrik duhet të jetë i plotë në të gjitha pikëpamjet siç është treguar edhe në projekt ,me skica përshkruara me specifikimet e udhëzimet e projektuesit . Montimi duhet të përfshijë me energji elektrike të gjithë paisjet elektrike të afëruara. Pika e furnizimit të paisjeve duhet të jetë kutija terminale furnizuese në pajim ose aparati i afërt mbyllës.

HARTUESI

Ing. Spiro Koti